

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Kujtim Krasniqi, në çështjen penale të të pandehurit L.S.nga P., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6238/2015, të datës 22.03.2017, jashtë seancës, me datë 17.01.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr. 6238/2015, të datës 22.03.2017, për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari;

L.S., nga i ati M. dhe nëna K., e gjinisë B., i lidhur me ..., në P., me vendbanim në lagjen "L." me numër personal ..., shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 21.09.2015, rreth orës 19:00, në Lagjen "L.", Hyrja ... në P., i pandehuri pas një konflikti verbal, për shkak të ashensorit të ndërtesës, e kishte goditur me grushte në kokë dhe fytyrë të dëmtuarin Gëzim Kelmendi, me ç'rast i kishte shkaktuar lëndime të lehta trupore,

- **Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej **300 (treqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 3 (tre) këste mujore në afat kohor prej 3 (tre) muaj e deri me datën 5 (pesë) të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prere e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **20 euro** për ekspertizë mjeko-ligjore si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **20 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

I dëmtuari: G.K. , me vendbanim në Lagjen "L." Hyrja ..., kati ..., Nr. ... P., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 6238/2015, të datës 22.03.2017, kundër të akuzuarit L.S.nga P., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së Prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenet 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: ekspertiza mjeko-ligjore, deklarata e të pandehurit, deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit, si dhe provat tjera përcjellëse janë prova të mjaftushme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenet 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenet 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, palët e dëmtuara janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.1575/17, të dt. 17.01.2018

Zyrtare Ligjore,
Dafina Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.